

VENDIM
Nr.668, datë 26.9.2012

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË E
TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, PËR ORGANIZIMIN DHE REALIZIMIN
E EKSPOZITËS “THESARE TË KULTURËS SHQIPTARE”, NGA DATA 20 NËNTOR 2012
DERI NË DATËN 6 JANAR 2013**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, t’i shtohet fondi prej 20 140 400 (njëzet milionë e njëqind e dyzet mijë e katërqind) lekësh, për organizimin dhe realizimin e ekspozitës “Thesare të kulturës shqiptare”, nga data 20 nëntor 2012 deri në datën 6 janar 2013.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha